



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 23.3.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Sërgjan Mitroviq, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Enver Hoti.

Munguan :Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Salih Salihu, Liburn Aliu, Driton Çausi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi sipas autorizimit të Kryetarit të Komisionit, **Andin Hoti**, anëtar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

**1. Shqyrtimi i projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore,**

**Anëtari i Komisionit Andin Hoti** i autorizuar nga **Kryetari i Komisionit**, njoftoi komisionin për takimin me Kryetarin e Kuvendit dt. 22.3.2018 në bazë të së cilës ka pasuar vendimi i mbledhjes plenare Nr. 06-V-087 dt. 23.3.2018 për përshpejtimin e shqyrtimit të projektligjeve të parapara me agjendën për reformë evropiane, në kuadër të së cilës është edhe projektligji për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore i cili ka kaluar në leximin e parë më 9 shkurt 2018 ndërkaq grupi punues i formuar në këtë komision më 9.3.2018, dhe të dërgohet për leximin e dytë më 30 mars 2018. Ai propozoi komisionit rrugën sa më të shkurtë të mundshëm për të dërguar këtë projektligj në leximin e dytë, mirëpo pasi që në këtë mbledhje mungoi përfaqësuesi i propozuesit të ligjit, komisioni u pajtua që grupi punues të takohet të hënën, pastaj të martën komisioni të shqyrtojë vërejtjet eventuale nga grupi punues.

E përgatiti:

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

Kryesuesi i mbledhjes,

**Andin Hoti**